

Raporti i vendimmarrjes së Komisionit të Përherëshëm

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTER
KËSHILLI BASHKIAK**

Komisioni i Përherëshëm i “Financave, Buxhetit , Pasurive Bashkiake dhe Planifikimit të Zhvillimit Strategjik”

RAPORT VENDIMMARRJE

Nr. 01 datë 27.01. 2026

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin

“Për një shtesë në VKB nr.101 datë 22.12.2025 “Për Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 dhe Buxhetit vjetor 2026” për projektin “CERV dhe CROSS”

Analiza ligjore: (bazueshmëria ligjore)

” Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr.9936 dt.26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr.10296, datë 8.7.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, ligjit 68/2017 “Për fianancat e vetëqeverisjes vendore”, Udhëzimit nr 09. datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 10, datë 12.07.2024 “Për rregjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare, si dhe VKB nr.101 datë 22.12.2025 “Për Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 dhe Buxhetit vjetor 2026” për projektin

Situata aktuale e funksionit (përshkrim i situatës së shërbimit / funksionit)

Projekti CERV:

Objektivat e Projektit

- Të forcojë ruajtjen, dokumentimin dhe valorizimin e Trashëgimisë Kulturore Fetare në zonën ndërkufitare Ioannina–Gjirokastrë, përmes një qasjeje të integruar dhe të qëndrueshme.
- Të digjitalizojë dhe bëjë të aksesueshme në mënyrë të hapur monumente, objekte fetare, artefakte dhe zejtaritë tradicionale të lidhura me trashëgiminë fetare, duke adresuar mungesën e dokumentimit dhe aksesit.
- Të identifikojë, dokumentojë dhe promovojë Trashëgiminë Kulturore Jomateriale Fetare, përfshirë histori gojore, rituale, praktika artizanale dhe narrativat komunitare si pjesë e identitetit të gjallë kulturor.
- Të zhvillojë përvoja turistike inovative dhe gjithëpërfshirëse përmes aplikimeve të avancuara AR/VR, platformës digjitale dhe aplikacionit mobil, duke rritur atraktivitetin dhe ndërveprimin e vizitorëve.
- Të krijojë itinerare tematike dhe të personalizuar turistike, që lidhin trashëgiminë materiale dhe jomateriale, duke diversifikuar ofertën turistike kulturore dhe fetare.
- Të rrisë kapacitetet e aktorëve lokalë të kulturës dhe turizmit, përmes programeve të trajnimit dhe toolkit-eve edukative mbi trashëgiminë digjitale, tregimin pjesëmarrës dhe turizmin e qëndrueshëm.
- Të nxisë bashkëpunimin afatgjatë ndërkufitar dhe zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm fetar, përmes krijimit të Rrjetit CROSS dhe hartimit të Udhëzuesit për Turizëm Fetar të Qëndrueshëm.

Situata financiare : (Shtesa / pakësime në buxhet)

Buxheti i projektit - Përshkrimi Narrativ

- Bashkia Gjirokastrë është partnere në projektin *CERV*, me një buxhet total prej

32,000.00 € . Ky buxhet është ndarë në kategori të ndryshme shpenzimesh, në përputhje me objektivat e projektit dhe rolin e Bashkisë në aktivitetet që do të zhvillohen.

1. Workshop, seminar and conferences (On - line, In – Situ)– (32,000.00 €)

Ky zë shpenzimesh përfshin organizimin Workshop, seminar dhe konferenca të stafit të Bashkisë Gjirokastrë në kuadër të projektit *CERV*. Shpenzimet përfshijnë kostot e udhëtimeve ndërkombëtare dhe vendore, akomodimin, si dhe dietat për personelin gjatë pjesëmarrjes në workshop, seminare dhe konferenca dhe ngjarje të tjera që lidhen me projektin.

Buxheti i projektit - Përshkrimi Narrativ

- Bashkia Gjirokastrë është partnere në projektin *CROSS*, me një buxhet total prej

Programi promovon shkëmbimet ndërmjet njerëzve nga vende, kultura, gjini dhe prejardhje të ndryshme socio-ekonomike, forcon mirëkuptimin dhe tolerancën reciproke dhe u jep atyre mundësinë të zgjerojnë këndvështrimin e tyre dhe të zhvillojnë një ndjenjë përkatësie dhe identiteti evropian përmes projekteve “Binjakëzimi i Qyteteve dhe Rrjetet e Qyteteve”. Në veçanti, projektet e Binjakëzimit të Qyteteve synojnë të promovojnë shkëmbimet ndërmjet njerëzve nga vende të ndryshme për të forcuar mirëkuptimin dhe tolerancën reciproke dhe për t’u dhënë atyre mundësinë të zgjerojnë perspektivën e tyre dhe të zhvillojnë një ndjenjë përkatësie dhe identiteti evropian. Duke ruajtur një qasje nga poshtë-lart (bottom-up), thirrja për propozime për Binjakëzimin e Qyteteve ofron mundësinë për t’u përqendruar në prioritetet e BE-së që mbulohen nga shtylla të tjera të programit. Kjo nënkupton, për shembull, përmirësimin e njohurive lokale mbi Kartën e të Drejtave Themelore të BE-së, përfshirë të drejtat e fëmijëve, të drejtat që rrjedhin nga shtetësia e BE-së, ose ndërtimin e njohurive dhe shkëmbimin e praktikave më të mira mbi përfitimet e diversitetit dhe barazisë gjinore, si dhe nxitjen e angazhimit qytetar, përfshirë fëmijët.

Objektivat e Projektit

Kjo thirrje synon të mbështesë projekte që bashkojnë një gamë të gjerë njerëzish nga qytete të binjakëzuara, me prejardhje të ndryshme socio-ekonomike, gjini dhe vende të ndryshme. Duke mobilizuar qytetarët në nivel lokal dhe të BE-së për të debatuar mbi çështje specifike të axhendës politike evropiane, kjo thirrje synon të promovojë mirëkuptimin e ndërsjellë, përfshirjen dhe diversitetin kulturor, si dhe të zhvillojë mundësi për angazhim qytetar në nivel të Bashkimit Evropian:

- të promovojë shkëmbime midis qytetarëve të vendeve të ndryshme;
- t’u ofrojë qytetarëve përvojë praktike mbi pasurinë dhe larinë e trashëgimisë së përbashkët të Bashkimit dhe t’i ndërgjegjësojë ata se këto përbëjnë themelin e një të ardhmeje të përbashkët;
- të garantojë marrëdhënie paqësore midis evropianëve dhe të sigurojë pjesëmarrjen e tyre aktive në nivel lokal;
- të forcojë mirëkuptimin e ndërsjellë dhe miqësinë midis qytetarëve evropianë;
- të inkurajojë bashkëpunimin ndërmjet bashkive dhe shkëmbimin e praktikave më të mira;
- të mbështesë qeverisjen e mirë vendore dhe
- të forcojë rolin e autoriteteve lokale dhe rajonale në procesin e integritetit evropian.

Projekti CROSS:

CROSS adopton një qasje të integruar ndaj menaxhimit të Trashëgimisë Kulturore duke kombinuar inovacionin digjital, përfshirjen e komunitetit dhe zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm. Projekti fokusohet në digjitalizimin sistematik dhe dokumentimin me akses të hapur të vendeve fetare të përzgjedhura, artefakteve dhe zanateve tradicionale të lidhura ngushtë me trashëgiminë fetare lokale. Këto zanate, që përfaqësojnë njohuri dhe aftësi të gjalla të transmetuara brez pas brezi, do të theksohen si një komponent thelbësor i identitetit kulturor të zonës dhe ofertës turistike, duke kontribuar në qëndrueshmërinë ekonomike lokale dhe në ruajtjen e vlerave kulturore jomateriale.

170,200.00 € . Ky buxhet është ndarë në kategori të ndryshme shpenzimesh, në përputhje me objektivat e projektit dhe rolin e Bashkisë në aktivitetet që do të zhvillohen.

1. Kostot e Stafit – (27,232.00 €)

Këto fonde mbulojnë shpenzimet për pagat, sigurimet shoqërore dhe detyrimet e tjera të lidhura me personelin e angazhuar drejtpërdrejt në projekt. Përfshirja e stafit siguron një menaxhim të vazhdueshëm dhe një zbatim efektiv të aktiviteteve, duke garantuar që Bashkia të jetë plotësisht e angazhuar në të gjitha fazat e projektit.

Burimi i financimit

Gr.00 Tit. AC115 Kap.2 Art 602 me kod projekti P822XXX “**CROSS**” në vlerën 11 732 891.36 ALL

Fondi në shumën 11 732 891.36 ALL Lekë do të përdoret sipas buxhetit të miratuar të projektit si më poshtë:

Gr.00 Tit. AC115 Kap.2 Art 602 me kod projekti P822XXX “Kostot e Stafit” në vlerën 1 750 836.37ALL

Gr.00 Tit. AC115 Kap.2 Art 602 me kod projekti P822XXX “Shpenzime për zyra dhe administrim” në vlerën 227 609.01 ALL

Gr.00 Tit. AC115 Kap.2 Art 602 me kod projekti P822XXX “Udhëtime dhe akomodim” në vlerën 210 100.33 ALL

Gr.00 Tit. AC115 Kap.2 Art 602 me kod projekti P822XXX “Ekspertizë dhe shërbime të jashtme” në vlerën 7 173 850.45ALL

Gr.00 Tit. AC115 Kap.2 Art 231 me kod projekti P822XXX “Pajisje” në vlerën 2 370 495.20ALL

Gr.00 Tit. AA115 Kap.2 Art 602 me kod projekti P413XXX “CERV” në vlerën 1 928 800 ALL

Fondi në shumën 1 928 800 ALL do të përdoret sipas buxhetit të miratuar të projektit si më poshtë:

Gr.00 Tit. AA115 Kap.2 Art 602 me kod projekti P360XXX workshop, seminare dhe konferenca (workshops/seminar/and conferences) në vlerën 1 928 800 ALL

Drejtoria / Sektori përgjegjës

Drejtoria e Finances

Monitorimi dhe raportimi : (kush monitoron, raporton dhe sa shpesh)

Komisioni i “Financave, Buxhetit , Pasurive Bashkiake dhe Planifikimit të Zhvillimit Strategjik” dhe Këshilli Bashkiak, sipas pershkrimeve ligjore dhe sa here ai e shikon te nevojshme.

Impakti social / grupet që preken:

Ky projekt vendim impakton te gjitha shtresat dhe kategorite e komunitet te bashkise Gjirrokaster si dhe zhvillimin ekonomik te krejt territorit te kesaj bashkie, trashegimine kulturore, turizmin.

A është objekt i konsultimit publik:

Po

Komisioni i Përhershëm i i **“Financave, Buxhetit , Pasurive Bashkiake dhe Planifikimit të Zhvillimit Strategjik”**

i mbledhur me datën 27 / 01 / 2026, shqyrtoi projekt vendimin ,relacionit e dokumentat shoqërues me propozimin

“Për një shtesë në VKB nr.101 datë 22.12.2025 “Për Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 dhe Buxhetit vjetor 2026” për projektin “CERV dhe CROSS”

paraqitur nga Kryetari i Bashkisë.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,


Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI

1. T’i propozojë Këshillit Bashkiak:

- a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
- b) miratimin e projektaktit
- c) refuzimin e miratimit të projektaktit
- d) miratimin e projekt-aktit me ndryshimet si vijon:
✓ Pika 1 (një) e projekt vendimit të ndryshoje në “ -----“

- ✓ Pika 4 (katër) e projekt vendimit të ndryshoje në “ -----“
- ✓ Tabela nr. 6 (gjashtë) e projekt vendimit të ndryshoje në “ -----“
- ✓ Paragrafi 15 (pesëmbëdhjetë) i projekt vendimit të ndryshoje në “ -----“




Kryetar i Komisionit

(emri, mbiemri, firma)

Sekretar i Komisionit

(emri, mbiemri, firma)



Datë 27 / 01 / 2026